



BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

MARS 2025

BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHETIT

MARS 2025

Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet e ZKPSH-së për muajin MARS 2025

**U. D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim
Kelmendi mori pjesë në takimin e 263-të të
Këshillit Prokurorial të Kosovës**

Prishtinë, 3 mars 2025 – U. D. Kryeprokurori i Shtetit mori pjesë në takimin e 263-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, me ç'rast mori vendimet si në vijim:



Miratoi Rregulloren për Themelimin dhe
Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit;

Miratoi Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimin
e Rregullore Nr.02/2023 për Veprimtarinë,
Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e
Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës;

Miratoi Raportin tremujor për periudhën tetor-
dhjetor 2024 për aktivitetet dhe rekomandimet e
Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve
Ekonomike;

Miratoi Raportin vjetor të mekanizmit përcjellës
ndërinstitucional për veprat penale karakteristike
për vitin 2024;

Miratoi pensionimin e prokurorit Besim Susuri në
Prokurorinë Themelore në Prizren, me ç'rast do t'ia
dërgojë Presidentes propozimin për lirim të tij
nga detyra;

Miratoi dorëheqjen e parakohshme të prokurorit
Agim Kurmehaj në Prokurorinë Themelore në Pejë
për shkaqe shëndetësore, me ç'rast do t'ia
dërgojë Presidentes propozimin për lirim të tij
nga detyra;

Zgjodhi prokuroren e Prokurorisë së Apelit, Shehribane Selimi-Muçaj, në detyrën e anëtares së Komisionit për Buxhet dhe Financa të KPK-së;

Aprovoi shpalljen e konkursit për avancim të një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë dhe të një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prizren;

Zgjodhi prokurorin Labinot Jetishi në detyrën e Zëvendësit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat dhe

Autorizoi Komisionin për Çështje Normative që të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Themelimin dhe Funkcionalizmin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike. Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale për Dhunën me Bazë Gjinore në Kontekstin e Migracionit.

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale për Dhunën me Bazë Gjinore në Kontekstin e Migracionit

Shkup, 5 mars 2025 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale për Dhunën me Bazë Gjinore në Kontekstin e Migracionit, e cila është mbajtur në Shkup me datë 5 dhe 6 Mars 2025.



Kjo konferencë është mbështetur nga projekti “Forcimi i proceseve të menaxhimit të migracionit, azilit dhe kthimit në Ballkanin Perëndimor”, që zbatohet nga Platforma Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimit i Përbashkët Hilfsëerk (JPC), dhe bashke financuar nga Fondi për Azilin, Migracionin dhe Integrimin (AMIF) dhe Ministria e Brendshme Federale e Austrisë.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit po merrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Drejt BE-së - Fuqizimi i Integritetit dhe Pavarësisë së Drejtësisë Penale në Ballkanin Perëndimor”

Ljubllanë, 10 mars 2025 - Me ftesë të Ministrisë së Drejtësisë së Sllovenisë dhe Iniciativës Globale kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, është duke marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare “Drejt BE-së - Fuqizimi i Integritetit dhe Pavarësisë së Drejtësisë Penale në Ballkanin Perëndimor”, që po mbahet në Ljubllanë të Sllovenisë.



Kjo konferencë bashkoi udhëheqës të institucioneve të drejtësisë nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe me gjerë, agjencive ligjzbatuese, organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe shoqërisë civile për të diskutuar prioritetet dhe sfidat e përbashkëta në çështjet e sundimit të ligjit, përkatësisht forcimin e kulturës së integritetit të institucioneve, angazhimit drejtë fuqizimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtarë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe

shkëmbimin e përvojave nga fusha e drejtësisë penale.

Përveç U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, pjesë e delegacionit të Republikës së Kosovës në këtë konferencë janë edhe Kryetari i Gjykatës Supreme, Ministrija e Drejtësisë, Drejtori i Policisë dhe Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Mbahet Takimi i 264-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 13 mars 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, mori pjesë në takimin e 264-të të organizuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, me ç'rast:



Miratoi kërkesën e Autoritetit Kompetent të Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe themeloi Panelin Hetimor për një rast disiplinor;

Miratoi Raportin vjetor të punës së Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2024;

Miratoi Raportin vjetor të punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2024;

Miratoi Raportin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës;

Caktoi prokurorin Agim Kuka në detyrën e Zëvendësit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat;

Caktoi prokuroren Bahtije Ademi në detyrën e Zëvendësës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Prokurori Ndërlidhës i Britanisë së Madhe për Ballkanin Perëndimor flasin për bashkëpunimin efektiv në çështjet juridike ndërkombëtare

Prishtinë, 18 Mars 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka pritur në takim Drejtuesin e Sektorit për prokurorët Ndërlidhës në Ambasadën Britanike në Tiranë, z. Derek Frame, Prokurorin Ndërlidhës të Britanisë së Madhe për Ballkanin Perëndimor dhe Oficerin Ndërlidhës të Drejtësisë Penale në Ambasadën Britanike në Tiranë, z. Enco Elezi.



Në fokus të diskutimeve të përbashkëta ishte bashkëpunimi efektiv në çështjet ligjore që përfshijnë ndihmën juridike ndërkombëtare, ekstradimin dhe temat tjera nga fusha e drejtësisë penale.



Palët shprehen angazhimin e tyre për të nisur iniciativa të reja të bashkëpunimit, veçmas në ndërtimin e një komunikimi zyrtar permanent dhe bashkëveprimi të qëndrueshëm në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Koordinatori i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave priti në takim përfaqësues të KFOR-it

Prishtinë, 20 Mars 2025 – Koordinatori i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave z. Burhan Maxhuni u takua sot me përfaqësuesit e KFOR-it Zviceran.

Në këtë takim u diskutuan çështje të rëndësishme të sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve, me fokus të veçantë në adresimin e dhunës në familje.



Poashtu gjatë këtij takimi, u shqyrtuan mundësitë për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe KFOR-it Zviceran, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit, parandalimit dhe reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje.



Koordinatori i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave z. Burhan Maxhuni theksoi rëndësinë e mbështetjes së komunitetit ndërkombëtar në forcimin e mekanizmave për parandalimin e dhunës dhe sigurimin e një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët, duke vlerësuar kontributin e KFOR-it në përpjekjet për të ndërtuar shoqëri më të drejtë dhe më të sigurt.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e KFOR-it ritheksuan angazhimin e tyre për të mbështetur institucionet vendore që punojnë për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje dhe për të forcuar masat e sigurisë në këtë drejtim.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, pjesëmarrës në tryezën e Këshillit të Evropës “Konsistenca e Jurisprudencës dhe harmonizimi i praktikës gjyqësore”

Prishtinë, 25 mars 2025 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në tryezën e organizuar nga Këshilli i Evropës me titull “Konsistenca e Jurisprudencës dhe harmonizimi i praktikës gjyqësore”, në kuadër të Projektit “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve Evropiane për të drejtat e njeriut”.



Duke folur për rëndësinë e konsistencës së jurisprudencës në sesionet e diskutimeve profesionale, ndër të tjera U.D. Kryeprokurori Kelmendi, ka potencuar se mungesa e prokurorëve në raport me numrin e gjyqtarëve si pasojë e mosmbështetjes buxhetore nga ana e pushteteve të tjera ndikon në mospërbushjen e parimit themelor të drejtësisë për një gjykim të drejtë, të pavarur dhe në afat të arsyeshëm dhe shkelë të drejtat e qytetarëve, të cilët me të drejtë presin efikasitet më të madh nga organet e drejtësisë.



Tutje, ai ka theksuar se mungesa e prokurorëve e bënë edhe më sfiduese pjesëmarrjen në seanca gjyqësore dhe ndikon në efektivitetin e trajtimit të kallëzimeve penale dhe marrjen e veprimeve procedurale sipas afateve ligjore.

Gjithashtu, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, ka deklaruar se zbatimi i kësaj konsistence dhe unifikimi i praktikave gjatë nxjerrjes së vendimeve gjyqësore ka efekt pozitiv në punën e Prokurorit të Shtetit për të krijuar praktika unifikuese edhe brenda sistemit prokurorial.



Krahas U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, në këtë tryezë ishin të pranishëm edhe Shefja e Zyrës së Këshillit të Evropës, përfaqësues të institucioneve nga gjyqësia kushtetuese, kryetarë të gjykatave, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Odës së Avokatëve, Avokatit të Popullit, shoqërisë civile dhe ekspertë ligjorë.

Udhëheqësi i zyrës për Rikthimin e Aseteve u takua me përfaqësuesë të Qendrës AIRE – Programi i Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesit e Ambasadës Britanike në Prishtinë

Prishtinë 25 mars 2025 – Udhëheqësi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit z. Bahri Hyseni, priti sot në takim të përbashkët përfaqësuesit e Qendrës AIRE – Programi i Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesit e Ambasadës Britanike në Prishtinë.



Fillimisht në këtë takim prokurori Hyseni i njoftoi të pranishmit për rolin e Zyrës për Rikthimin e Aseteve dhe hapat të cilat janë ndërmarrë lidhur me funksionalizimin e kësaj zyreje. Poashtu gjatë këtij takimi u diskutua edhe synimi i kësaj Zyreje që në të ardhmen të bëhet hartimi i ligjit për Zyrën për Rikthimin e Aseteve, bazuar në rekomandimet e Direktivës së BE-së, e cila ndër të tjerash e obligon çdo shtet për themelimin e zyrave të tilla.

Përfaqësuesit Qendrës AIRE, e cila është e përkushtuar për të forcuar kapacitetet e sistemeve gjyqësore në rajon për të trajtuar këto sfida, mes të tjerash përmes përdorimit efektiv të rikuperimit të pasurive si mjet për të luftuar dhe penguar aktivitetet kriminale dhe ato financiare ilegale, ofruan trajnime dhe vizita studimore në vendet e Ballkanit Perëndimorë për zyrtarët e Zyrës për Rikthim të Aseteve, me qëllim të operimit sa më efikas dhe efektiv të kësaj zyreje.



Nga ana tjetër edhe në këtë takim përfaqësuesit e Ambasadës Britanike në Kosovë, shprehën gatishmërinë e tyre për bashkëpunim me këtë Zyrë, duke ofruar ndihmë në hartimin e koncept dokumentit për Ligjin për Zyrën për Rikthim të Aseteve dhe lidhjen e marrëveshjeve për bashkëpunim në mes kësaj Zyreje dhe zyrave homologe në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Koordinatori i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave u takua me udhëheqësit e Zyrave Regjionale për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Prishtinë, 26 mars 2025 – Koordinator i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave z. Burhan Maxhuni, u takua me stafin e zyrës qendrore dhe me udhëheqësit e zyrave regjionale për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, ku temë kryesore ishte inspektimi i lëndëve të trajtuara në të gjitha zyrat regjionale gjatë vitit 2024 dhe menaxhimi efikas i zyrave regjionale.



Gjatë këtij takimi, u analizua progresi i trajtimit të rasteve gjatë vitit 2024, duke u fokusuar në përmirësimin e shërbimeve për viktimat dhe

adresimin e sfidave në procesin e mbrojtjes dhe ndihmës për viktimat e krimit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua menaxhimit dhe koordinimit më efikas të zyrave regjionale, në mënyrë që të sigurohet mbështetje më e madhe për viktimat dhe të rritet transparenca në trajtimin e rasteve.

Koordinatori Maxhuni theksoi rëndësinë e standardizimit të procedurave dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për të garantuar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe efektive në ofrimin e ndihmës për viktimat. Gjithashtu, u diskutuan strategjitë për forcimin e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimin e infrastrukturës së zyrave rajonale.



Ky takim shërben si një hap i rëndësishëm në drejtim të rritjes së efikasitetit të sistemit të mbrojtjes dhe ndihmës për viktimat e krimit, duke siguruar që çdo rast të trajtohet me profesionalizëm dhe përkushtim.

Në përmbyllje të takimit, Koordinator i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave z. Burhan Maxhuni, falënderoj stafin për angazhimin dhe përkushtimin në ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e krimit, si dhe theksoi rëndësinë e përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve për viktimat dhe përkushtimin për të garantuar një sistem më efikas dhe të përgjegjshëm.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit kërkon efikasitet në trajtimin e kallëzimeve penale

Prishtinë 28 mars 2025 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, mbañti takimin e radhës të kolegjiut me

kryeprokurorët dhe përfaqësuesit e prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku të pranishëm në këtë takim ishin edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Ardian Hajdaraj, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi.



Takimi u përqendrua në diskutimin e çështjeve të rëndësishme profesionale, ku ndër më kryesorët ishin; trajtimi dhe ecuria e procedimit të kallëzimeve penale brenda afateve ligjore - veçanërisht atyre me kryerës të panjohur, angazhimi i prokurorëve të shtetit në shkatërrimin e narkotikëve të konfiskuar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe avancimi i përdorimit të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) nga ana e kryeprokurorëve dhe prokurorëve.



Në frymën e këtij diskutimi, U.D. Kryeprokurori i Shtetit theksoi rëndësinë e ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punën e prokurorive dhe kërkoi nga të gjithë kryeprokurorët të vazhdojnë përpjekjet e tyre në përmbushjen e këtyre qëllimeve institucionale.

Urimi i U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, me rastin e festës së Fitër Bajramit

Prishtinë, 30 mars 2025 –



Të nderuar shqiptar të besimit mysliman,

Me rastin e festës së Fitër Bajramit, uroj nga zemra që kjo ditë e shenjtë t'iu sjellë Ju dhe familjeve tuaja paqe, lumturi dhe begati.

Angazhimi ynë si individ por edhe si bartës të funksioneve për të siguruar drejtësi dhe respektim të lirive dhe të drejtave universale të njeriut mbetet i palëkundur.

Andaj, kjo festë është një moment i veçantë që na fton të gjithëve të jemi të bashkuar dhe të forcojmë lidhjet tona njerëzore, duke na ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, të barabartë dhe solidare.

Le të jetë kjo festë lartësim i mirëkuptimit dhe harmonisë ndërmjet nesh!

Me respekt,

U.D. Kryeprokurori i Shtetit

Besim Kelmendi